



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.963/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Kymete Kicaj, kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevci anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Mimoza Berisha nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Drenas paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.963/2021 i datës 04.11.2021, i kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Mimoza Berisha nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, më të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 e kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Mimoza Berisha nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, më të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave. në vendvotimet 0319E/01R, 0319E/02R, 0324E për arsye se dyshon se ka pasur manipulim dhe nuk i figurojnë votat e familjarëve të saj. Si dëshmi ka bashkangjitur Formularët e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve dhe Formularët e Rezultateve të Kandidateve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Mimoza Berisha nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, ka paraqitur apel më të cilën ka kërkuar rinumërimin e vendvotimet 0319E/01R, 0319E/02R, 0324E. Si dëshmi ka bashkangjitur formular te vendvotimit 0319/01, dhe 0319E/02R ku pas kërkimeve rezulton se ka përputhje te votave ne listën përfundimtare te KQZ-se me formularët e dorëzuar ku ka nga 2 vota ne këto qendra ashtu si dhe ne formular, ndërsa për kërkesën për rinumërim te vendvotimit 0324E nuk e ka saktësuar plotësisht vendvotimin.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.963/2021 më datën 07.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.